



Prishtinë, 12 korrik 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1014_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 37, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Kërkesën e ndërmarrjes "EVN TRADING" L.L.C., me adresë: Mustafë Kruja Nr.14, Prishtinë, Republika e Kosovës, të bërë me datë 28 maj 2018 për ndërprerje/revokim të licencës për import dhe eksport të energjisë elektrike.

në seancën e mbajtur me datë 12 korrik, 2018 nxori këtë:

VENDIM

- I. I NDËRPRITET** Licenca për import dhe eksport të energjisë elektrike ndërmarrjes "EVN TRADING" L.L.C (Licenca me numër ZRRE/Li_42/15), e cila ishte lëshuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 15 qershor 2015, me Vendimin V_738_2015.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 15.06.2015, ka nxjerr vendim për lëshim të licencës për import dhe eksport të energjisë elektrike ndërmarrjes "EVN TRADING" L.L.C për periudhën nga data 15 qershor 2015 deri më 15 qershor 2020.
- Ndërmarrja "EVN TRADING", e përfaqësuar nga menaxheri i saj nëpërmjet komunikimit elektronik me datë 28 maj 2018 ka kërkuar t'i ndërpritet/revokohet licenca për import dhe eksport të energjisë elektrike me numër licence ZRRE/Li_42/15, e cila ishte e vlefshme nga data 15 qershor 2015 deri me datë 15 qershor 2020.
- Me kërkesë të Rregullatorit, ndërmarrja EVN TRADING L.L.C me datë 05.07.2018 ka dërguar Certifikatën nga Administrata Tatimore e Kosovës (të datës 29.06.2018) që nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore.



- Me datë 17.05.2018 EVN TRADING L.L.C ka kërkuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), të mos jetë më palë e Marrëveshjes për Aderim. Kërkesa i është aprovuar nga KOSTT në pajtim me Procedurat e Rregullave të Tregut, dhe meqenëse nuk ka pasur dhe as nuk ka ndonjë kontest apo obligim financiar ndaj Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe as Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO), nga data 01.06.2018 kjo ndërmarrje nuk është më Palë e Marrëveshjes për Aderim sipas komunikimeve zyrtare elektronike me përfaqësues të KOSTT).
 - Rregullatori ka vlerësuar kërkesën e kësaj ndërmarrjes EVN TRADING L.L.C dhe dokumentet/informacionet e sipërpërmendura, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Me ndërprerje të licencës për import dhe eksport të energjisë elektrike, ndërmarrjes EVN TRADING L.L.C , nga data e lëshimit të këtij vendimi i pushojnë të gjitha të drejtat edhe detyrimet që ka pasur sipas licencës së lëshuar nga Rregullatori.
- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit **“EVN TRADING” L.L.C.**
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Selçijaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar